g) **“Pakicë”**, trajtimi dhe/ose përpunimi i mishit dhe ruajtja e tij në pikën e shitjes ose ofrimit te konsumatori i fundit, duke përfshirë furnizuesit e ushqimit, mensat e kompanive, furnizim ushqimi institucional, restorantet dhe operacione të tjera të ngjashme me shërbimin e ushqimit, dyqanet, qendrat e shpërndarjes së supermarketeve dhe dyqanet me shumicë;

h) **“Konsumator final”**, konsumatori i fundit i mishit të prerë që nuk e përdor atë si pjesë e një veprimtarie apo veprimtarie të biznesit ushqimor.

4. Operatorët e biznesit ushqimor gjithashtu duhet të tregojnë në etiketat:

- a) shtetin, rajonin e lindjes;
- b) shtetin, rajonin ku u bë majmëria;
- c) shtetin, rajonin ku u bë therja.

Kur mishi i gjedhit rrjedh nga kafshët e lindura, të rritura dhe të therura në të njëjtin shtet, informacioni mund të jepet si “Origjina: (emri i shtetit, rajonit)”.

4.1. Në zbatim të pikës 4, për mishin që merret nga kafshët e lindura para 1 janarit 1998, ku informacioni në lidhje me vendin e lindjes dhe/ose vendin e rritjes, përveç vendit të fundit të rritjes, nuk është i disponueshëm, treguesi i vendit të lindjes dhe/ose vendi i rritjes do të zëvendësohet me treguesin “(lindur para 1 janarit 1998)”.

4.2. Për mishin që merret nga kafshët e importuara të gjalla ku informacioni lidhur me vendin e lindjes dhe/ose vendin e rritjes, përveç vendit të fundit të rritjes, nuk është i disponueshëm, treguesi i vendit të lindjes dhe/ose vendit të rritjes do të zëvendësohet me treguesin “(import i gjallë në Shqipëri)” ose “(import i gjallë nga [emri i shtetit])”.

5. Për thjeshtimin e treguesit të origjinës, në zbatim të pikës 4, për mishin e gjedhit që origjinoi nga kafshët të cilat janë rritur për 30 ditë ose më pak:

a) në shtetin, rajonin e lindjes;

b) në shtetin, rajonin ku është bërë therja e kafshëve;

treguesi i shtetit ose rajonit, si shteti ose rajoni ku bëhet mbarështimi, nuk do të kërkohet, me kusht që ato kafshë u rriten në një shtet tjetër për një periudhë më të gjatë se 30 ditë.

6. Mbajtja e një sistemi etiketimi të detyrueshëm siguron një lidhje ndërmjet, nga njëra anë, identifikimit e karkasave, çerekëve ose pjesëve të mishit dhe, nga ana tjetër, kafshës individuale, kur kjo është e mjaftueshme për të mundësuar saktësinë e informacionit në etiketë. Ky sistem shërben për të përcaktuar madhësinë e grupit. Madhësia e grupit të përcaktohet:

a) gjatë prerjes së karkasave ose çerekëve, nga numri i karkasave ose çerekëve të prera së bashku dhe që përbëjnë një grup për stabilimentin prerës në fjalë;

b) gjatë prerjes ose grirjes së mëtejshme, nga numri i karkasave ose çerekët, mishi i të cilave përbën një grup për stabilimentin prerës dhe grirës në fjalë;

Madhësia e grupit nuk mund, në asnjë rast, të tejkalojë prodhimin e një dite.

6.1 Kur strukturojnë grupet, e përmendura në pikën 6, operatorët të sigurojnë që:

a) të gjitha karkasat ose çerekët në një grup të prera së bashku janë të kafshëve të lindura nga i njëjti vend, të rritura në të njëjtin vend apo vende dhe të therura në të njëjtin vend dhe në të njëjtën thertore;

b) të gjitha karkasat nga të cilat mishi në një grup i nënshtrohet prerjes së mëtejshme në përputhje me germën “a” duhet të jenë prerë në të njëjtën stabiliment prerës;

c) i gjithë mishi në një grup që pëson grirje është nga kafshët e therura në të njëjtin vend.



6.2 Duke u shmangur nga kërkesat në lidhje me të njëjtën thertore dhe të njëjtin stabiliment prerës e përcaktuar në pikën 6.1/b, gjatë prodhimit të mishit të prerë, operatorët duhet të autorizohen nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) për të krijuar grupe nga mishi i kafshëve të therura në një maksimum prej tri thertoreve të ndryshme dhe nga karkasat të prera në maksimum në tri stabilimente të ndryshme prerëse.

6.3 Me përjashtim të pikës 6.1/b, gjatë prodhimit të mishit të copëzuar, operatorët, kur strukturojnë grup, duhet të përmbushin vetëm kërkesat në lidhje me të njëjtin vend të therjes.

7. Për mishin e grirë të gjedhit, informacioni i cili duhet të përfshihet në etiketë, të jetë:

a) numri i miratimit të thertoresh në të cilën kafsha ose grupi i kafshëve është therur dhe shteti, vendi në të cilën kjo thertore është ngritur. Në etiketë të shënohet: “Therur në”, (emri i shtetit, rajonit), (numri i miratimit);

b) numri i miratimit të stabilimentit të prerjes në të cilin kryhen operacionet e prerjes së karkasës ose grupit të karkasave, si dhe emri i shtetit, rajonit në të cilën është ngritur ky stabiliment. Në etiketë të shënohet: “Prerë në: (emri i shtetit, rajonit), (numri i miratimit)”;

c) data e grirjes.

8. Për mishin e copëzuar, me përjashtim të pikës 7, gjerat “a” dhe “b”, operatorët e biznesit ushqimor të tregojnë në etiketat e mishit të copëzuar:

a) vendin e therjes së kafshëve nga të cilat merret mishi i copëzuar: në etiketë të shënohet: “Therur në, (emri i shtetit, rajonit)”;

b) vendi në të cilin është prodhuar mishi i copëzuar dhe numri i miratimit të stabilimentit në të cilën është prodhuar; në etiketë të shënohet: “Prodhuar në (emri i shtetit, rajonit të prodhimit dhe numri i miratimit të stabilimentit)”;

c) vendet në të cilat kanë lindur dhe rritur kafshët që përbëjnë grupin; në etiketë të shënohet: “Lindur dhe rritur në (emrat e vendeve në të cilët kanë lindur dhe rritur kafshët)”.

Me përjashtim të germave “a” dhe “c”, ku të gjitha kafshët e grupit janë lindur, rritur dhe therur në të njëjtin shtet, operatorët duhet të autorizohen nga AKU-ja, që të përdorin treguesin “Shteti i origjinës” ndjekur nga emri i shtetit ose vendit në të cilin kafshët ishin lindur, rritur dhe therur.

9. Për mishin e prerë të parapaketuar, operatorët e biznesit ushqimor që përfitojnë nga mundësia e ofruar nga pika 6.2 e këtij udhëzimi duhet të tregojnë në etiketimin për mishin e prerë të parapaketuar, përveç asaj të parashikuar në pikën 7, germa “a” të këtij udhëzimi, informacionin si më poshtë:

a) vendin e therjes së kafshëve, ndjekur nga numri i miratimit të thertoresh ose, sipas rastit, dy ose tri thertoreve në të cilën u therën kafshët që përbëjnë grupin; në etiketë të shënohet: “Kafshët në grupin e therur në (emri i shtetit, rajonit të therjes) (numri/at i miratimit i thertoresh ose dy ose tri thertoreve në fjalë)”;

b) vendi në të cilin janë prerë karkasat, ndjekur nga numri i miratimit të stabilimentit të prerjes ose, sipas rastit, e dy ose tri stabilimentëve të prerjes në të cilat u prenë karkasat; në etiketë të shënohet: “Prerja e mishit në grup në: (emri i shtetit, rajonit në të cilin është prerë mishi) (numri/at i miratimit të stabilimentit ose dy ose tri stabilimentëve në fjalë)”.

10. Për mishin e prerë jo të parapaketuar, operatorët sigurojnë që, kur zbatohet shmangia e parashikuar në pikën 6.1 të këtij udhëzimi, përbërja e grupeve e të gjithë mishrave të prera jo të paketuara që vendosen në të njëjtën kohë në dyqanet me pakicë për shitje të konsumatori i fundit është në përputhje me pikën 6.2 të këtij udhëzimi.

a) Me përjashtim të pikës 7, gjerat “a” dhe “b” të këtij udhëzimi, në pikat e shitjes për konsumatorin e fundit, operatorët duhet të etiketojnë të gjithë mishin e prerë jo të parapaketuar nxjerrë për shitje duke treguar emrin e vendit në të cilin u lindën, u rritën dhe u therën kafshët nga të cilat origjinon mishi, ndjekur nga emri i vendit në të cilin u prenë karkasat.

Mishi i kafshëve të lindura dhe/ose të rritura dhe/ose të therura në vende të ndryshme të jenë qartësisht të ndara kur nxirren për shitje. Informacioni do të shfaqet në tregun e shitjes pranë mishit në mënyrë që të lejojë konsumatorin e fundit ta dallojë lehtësisht mishin me origjinë të ndryshme.

Operatorët, që nxjerrin mish të prerë jo të parapaketuar së bashku për shitje çdo ditë do të regjistrojnë datën, numrat e miratimit të thertoresh në të cilat kafshët u therën dhe stabilimentit prerës në të cilat u prenë karkasat. Ata duhet të sigurojnë



këtë informacion për konsumatorët që e kërkojnë atë.

b) Me përjashtim të pikës 6 dhe duke parashikuar që kërkesat e parashtruara në germën “a” të kësaj pike janë plotësuar, në rastin e mishit të gjedhit jo të parapaketuar dhe/ose të mishit të viçit që nxirret për shitje te konsumatori i fundit, madhësia e grupit mund të tejkalojë prodhimin një ditor.

11. Për kontrollet, operatorët e biznesit ushqimor, në çdo kohë, të lejojnë AKU-së, të hyjë në ambientet e saj dhe t’u venë në dispozicion të gjitha të dhënat që vërtetojnë se informacioni mbi etiketat në fjalë është i saktë.

AKU-ja kryen kontrole të rregullta në bazë të analizës së riskut, e cila duhet të marrë në konsideratë, në veçanti, kompleksitetin e specifikimit në fjalë. Për çdo kontroll duhet të bëhet një raport inspektimi për të përfshirë çdo mangësi, si dhe masat e propozuara për të korrigjuar situatën, afatet dhe sanksionet e vendosura.

Operatorët e biznesit ushqimor, t’i komunikojnë të gjitha informacionet përkatëse tek AKU-ja.

12. AKU-ja të bëjë regjistrimin e specifikimeve të miratuara dhe, në veçanti, të secilit operator të biznesit ushqimor përgjegjës për etiketimin e mishit të gjedhit.

13. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi 1 vit pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

UDHËZIM
Nr. 583, datë 14.10.2019

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE
PROCEDURAVE STANDARDE TË
KALIMIT TË PRONËS NË
ADMINISTRIM**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 10 dhe nenit 231, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton kriteret dhe procedurat standarde për kalimin në administrim të pasurive kulturore publike të:

- a) institucioneve publike qendrore;
- b) njërive të vetëqeverisjes vendore;
- c) fondacioneve të themeluara nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 28, të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
- d) fondacioneve të posaçme të trashëgimisë kulturore.

2. Ky udhëzim zbatohet për kalimin në administrim të pasurive kulturore publike si vijon:

a) pasuritë kulturore të paluajtshme me vlera arkeologjike dhe atyre të kategorizuara “me rëndësi universale”, “me rëndësi kombëtare” ose “me rëndësi lokale”;

b) muzetë publikë qendror.

3. Në rastin e shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij kreu, pasuritë kulturore publike të luajtshme kalojnë në administrim së bashku me pasurinë kulturore publike të paluajtshme sipas parashikimeve në marrëveshjen e administrimit.

4. Pasuria kulturore publike u kalon në administrim subjekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu me qëllim mbrojtjen, ruajtjen, restaurimin, vlerësimin dhe dhënien në përdorim sipas formave të parashikuara në ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

5. Kalimi në administrim direkt i pasurive kulturore publike, në favor të institucioneve publike qendrore ose njërive të vetëqeverisjes vendore bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

6. Kalimi në administrim indirekt i pasurive kulturore “me rëndësi kombëtare” dhe “me rëndësi lokale” fondacioneve të themeluara nga institucionet e specializuara ose ministria përgjegjëse për kulturën, ose fondacioneve të posaçme të bashkëthemeluara nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me partnerët strategjikë, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

7. Kalimi në administrim indirekt të pasurive kulturore “me rëndësi universale” fondacioneve të



themelua nga institucionet e specializuara ose ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, ose fondacioneve të posaçme të bashkëthemeluara nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me partnerë strategjikë, miratohet nga Kuvendi.

8. Përveç parashikimeve të këtij udhëzimi, propozimi për miratim në Këshillin e Ministrave, ose në Kuvend duhet të jetë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë vendimmarrjen në këto organe.

II. KRITERET DHE PROCEDURAT PËR KALIMIN NË ADMINISTRIM DIREKT TË PASURIVE KULTURORE INSTITUCIONEVE PUBLIKE QENDRORE OSE NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

1. Pasuria kulturore publike i kalon në administrim institucionit publik qendror ose njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas procedurës së parashikuar në këtë krye, kur këto të fundit plotësojnë në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme:

- a) pasuria është nën juridiksionin territorial të tij;
- b) siguron ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin më efektiv të pasurisë kulturore;
- c) siguron personelin e nevojshëm dhe të kualifikuar, kapacitetet teknike dhe financiare, për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin e pasurisë kulturore, si dhe funksionet e tjera në bazë të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
- d) garanton shërbimet dhe aksesin për publikun;
- e) pranon zbatimin e planit të menaxhimit të pasurisë kulturore të paluajtshme të miratuar.

2. Institucioni publik qendror apo njësia e vetëqeverisjes vendore, që kërkon marrjen në administrim direkt të një pasurie kulturore publike, pronë shtetërore, paraqet kërkesën pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kartelën e regjistrimit të pasurisë të lëshuar nga zyra përgjegjëse e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të kërkesës;
- b) organikën e strukturës përgjegjëse për administrimin e pasurisë kulturore publike;
- c) plani i detajuar i buxhetit të miratuar dhe projektbuxhetit të vitit pasardhës;
- d) planin e zhvillimit të pasurisë kulturore publike;
- e) deklaratë për pranimin e planit të menaxhimit të pasurisë kulturore publike të paluajtshme;

f) vendimin e organit publik qendror, ose vendimin e organit vendimmarrës të njësisë së vetëqeverisjes vendore në rastin e kërkesës për kalim në administrim të pasurisë kulturore publike në pronësi ose përgjegjësi administrimi të njërive të vetëqeverisjes vendore.

3. Gjatë shqyrtimit të kërkesës ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore mund të kërkojë dokumentacion shtesë.

4. Kërkesa e institucionit publik qendror ose njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe dokumentacioni përkatës i përcillet KKMPK-së, e cila brenda 30 ditëve shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e dorëzuar dhe në përfundim merr vendim për pranimin ose jo të kërkesës.

5. Pas miratimit të kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, KKMPK-ja nëpërmjet sekretarisë së saj teknike, harton projekt-marrëveshjen nëpërmjet të cilës përcaktohen kushtet e administrimit të pasurisë kulturore.

6. Projekt-marrëveshja i njoftohet institucionit publik qendror ose njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, për t'u dakordësuar brenda 10 ditëve nga njoftimi.

7. Pas dakordësisë së palëve mbi projekt-marrëveshjen, KKMPK-ja brenda 30 ditëve merr në shqyrtim praktikën dhe vendos:

a) miratimin ose jo të marrëveshjes së dakordësuar për kalimin e pasurisë kulturore publike në administrim direkt;

b) në rast miratimi, autorizimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore për nënshkrimin e marrëveshjes për kalimin e pasurisë kulturore publike në administrim direkt.

8. Brenda 10 ditëve nga vendimi i KKMPK-së, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucioni publik qendror ose njësia e vetëqeverisjes vendore nënshkruajnë marrëveshjen e administrimit.

9. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore i propozon Këshillit të Ministrave kalimin e pasurisë kulturore publike në administrim direkt, së bashku me marrëveshjen përkatëse të administrimit ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucionit publik qendror ose njësisë së vetëqeverisjes vendore.



III. KRITERET DHE PROCEDURA PËR KALIMIN NË ADMINISTRIM INDIREKT TË PASURISË KULTURORE FONDACIONEVE TË THEMELUARA NGA INSTITUCIONET E SPECIALIZUARA TË TRASHËGIMISË KULTURORE, MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE, OSE MUZETË PUBLIKË QENDROR

1. Pasuria kulturore publike i kalon në administrim indirekt fondacionit të themeluar nga institucioni i specializuar i trashëgimisë kulturore, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, ose muzeu publik qendror, sipas procedurës së parashikuar në këtë krye, kur përmbushen kriteret e mëposhtme:

- a) sigurohet ruajtja, mbrojtja, vlerësimi dhe administrimi më efektiv i pasurisë kulturore;
- b) sigurohet personeli i nevojshëm dhe i kualifikuar, kapacitetet teknike dhe financiare për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin e pasurisë kulturore, si dhe funksionet e tjera në bazë të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
- c) garantohet shërbimi dhe akses i publikun;
- d) pranohet zbatimi i planit të menaxhimit të pasurisë kulturore të paluajtshme të miratuar.

2. Institucioni i specializuar i trashëgimisë kulturore, i cili do të themelojë fondacionin, paraqet kërkesën pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) relacion mbi nevojën e kalimit në administrim indirekt të pasurisë kulturore dhe krijimit për këtë qëllim të fondacionit;
- b) strukturën organizative dhe funksionale të brendshme të fondacionit;
- c) deklaratën për zbatimin e planit të menaxhimit;
- d) planin e biznesit për zhvillimin e aktivitetit të administrimit, duke parashtruar dhe justifikuar në terma ekonomik, financiar dhe teknik efektivitetin në administrimin e pasurisë kulturore;
- e) dokument që vërteton natyrën, burimin dhe vlerën e fondeve të siguruar për administrimin e pasurisë kulturore nga fondacioni;
- f) dokumentacionin lidhur me sigurimin e kapaciteteve teknike për realizimin e qëllimit.

3. Kërkesa e institucionit të specializuar të trashëgimisë kulturore dhe dokumentacioni përkatës i përcillet KKMPK-së, e cila brenda 30 ditëve shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e

dorëzuar dhe në përfundim merr vendim për pranimin ose jo të kërkesës, pasi ka bërë një vlerësim krahasues në terma ekonomiko-financiar dhe të efektivitetit.

4. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore njofton institucionin e specializuar të trashëgimisë kulturore për vendimarrjen e KKMPK-së brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

5. Brenda 90 ditëve nga vendimi i KKMPK-së, institucioni i specializuar i trashëgimisë kulturore përfundon procedurat për themelimin dhe regjistrimin e fondacionit pranë organeve kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse.

6. Pas themelimit të fondacionit, KKMPK-ja nëpërmjet sekretarisë së saj teknike, harton projekt marrëveshjen e administrimit të pasurisë kulturore publike.

7. KKMPK-ja brenda 30 ditëve merr në shqyrtim projekt marrëveshjen dhe vendos:

- a) miratimin ose jo të marrëveshjes së dakordësuar për kalimin e pasurisë kulturore publike në administrim indirekt;
- b) në rast miratimi, autorizimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore për lidhjen e marrëveshjes së administrimit.

8. Pas miratimit nga KKMPK-ja, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidh marrëveshjen e administrimit me fondacionin.

9. Për kalimin në administrim indirekt të pasurisë kulturore publike fondacioneve të krijuara nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, kjo e fundit përgatit dokumentacionin e cituar në pikën 2 të këtij kreu, së bashku me relacionin shpjegues mbi nevojën e kalimit në administrim indirekt. Ministria vijon me procedurën, sipas pikës 3, 5, 6, 7, 8 dhe 10 të këtij kreu.

10. Marrëveshja e nënshkruar miratohet nga Këshilli i Ministrave në rastin e kalimit të administrimit të pasurisë kulturore “me rëndësi kombëtare”, e më pas nga Kuvendi në rastin e kalimit të administrimit të pasurisë kulturore “me rëndësi universale”.

11. Për kalimin në administrim indirekt të muzeve publike qendror zbatohen të njëjtat kritere dhe procedura të parashikuara në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 10 të këtij kreu, me iniciativë të muzeut.



IV. KRITERET DHE PROCEDURAT PËR KALIMIN NË ADMINISTRIM INDIREKT TË PASURISË KULTURORE FONDACIONIT TË POSAÇËM TË TRASHËGIMISË KULTURORE

A. Procedura për kalimin në administrim indirekt me kërkesë të partnerit strategjik

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore mund të bashkëthemelojë fondacione të posaçme për administrimin indirekt të pasurive kulturore publike me partnerë strategjikë që përmbushin kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 625, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit” dhe kriteret si më poshtë vijon:

a) të ketë fituar personalitet juridik nëpërmjet regjistrimit në organin kompetent prej jo më pak se 5 vjetësh;

b) të ketë pjesë të objektit, veprimtari në fushën e trashëgimisë kulturore;

c) të mos jetë i dënua për vepra penale në fushën e trashëgimisë kulturore;

d) të mos jetë në procedura likuidimi, falimentimi, apo forma të tjera administrimi;

e) të ketë eksperiencë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar prej jo më pak se 5 vjet në fushën e trashëgimisë kulturore;

f) të ketë hartuar dhe/ose realizuar projekte në fushën e trashëgimisë kulturore dhe muzeve gjatë 5 viteve të fundit të aktivitetit të tij;

g) të sigurojë ekspertizën e nevojshme për kryerjen e funksioneve ruajtëse dhe mbrojtëse sipas natyrës së pasurisë kulturore referuar legjislacionit në fuqi në fushën e trashëgimisë kulturore.

h) të ketë kontribut të njohur financiar, shkëmbim të vlerave intelektuale dhe profesionale, në fushën e trashëgimisë kulturore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

i) të propozojë nëpërmjet planit të biznesit një model administrimi që të garantojë ruajtjen, mbrojtjen, zhvillimin e qëndrueshëm, promovimin, gëzimin publik të pasurisë kulturore;

j) të ketë burime të mjaftueshme financiare për të ndërmarrë administrimin e pasurisë kulturore;

k) të ardhurat e subjektit të burojnë nga veprimtari të ligjshme;

l) të sigurojë kapacitetet teknike, ekonomike dhe ligjore për të marrë përsipër administrimin e pasurisë kulturore.

2. Partneri strategjik i interesuar paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore kërkesën për themelimin e fondacionit të posaçëm me qëllim administrimin e pasurisë kulturore, e cila përmban dokumentacionin e mëposhtëm:

a) letrën për shprehje interesi, ku identifikohet pasuria kulturore publike që propozohet të administrohet nëpërmjet fondacionit të posaçëm;

b) dokumentacion nga organet kompetente për regjistrim në regjistrat publik;

c) dokumentacion nga organet kompetente mbi gjendjen gjyqësore;

d) dokumentacion që provon që nuk është në proces falimentimi, likuidimi ose forma të tjera administrimi;

e) planin e biznesit për zhvillimin e aktivitetit të fondacionit të posaçëm për kryerjen e administrimit dhe aktiviteteteve të tjera të parashikuara nga ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

f) një deklaratë në të cilën pranon zbatimin e planit të menaxhimit të miratuar;

g) dokumentacion që vërteton zotërimin e mjeteve financiare për të zhvilluar projektin e marrjes në administrim të pasurisë kulturore;

h) deklaratë mbi ligjshmërinë e burimit të të ardhurave;

i) bilancin e 5 viteve të fundit, të depozituar në organet e administratës tatimore;

j) vërtetim dhe/ose kontratë mbi projektet e realizuara në fushën e trashëgimisë kulturore gjatë 5 viteve të fundit;

k) vërtetim dhe/ose kontratë mbi bashkëpunime të mëparshme me qeverinë dhe/ose institucione shqiptare në fushën e trashëgimisë kulturore.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruet i përcillet KKMPK-së, e cila brenda 30 ditëve shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e dorëzuar dhe në përfundim merr vendim për pranimin ose jo të kërkesës së partnerit strategjik, pasi ka bërë një vlerësim krahasues në terma ekonomiko-financiar dhe të efektivitetit.

4. KKMPK-ja ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë dhe nëse e sheh të arsyeshme mund të thërrasë dhe të dëgjojë palën e interesuar. Në rast se KKMPK-ja gjatë shqyrtimit



të dokumentacionit vëren se ka mungesa, njofton palën e interesuar për plotësimin e dokumentacionit duke i lënë një afat jo më shumë se 10 ditë.

5. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore njofton partnerin strategjik për vendimarrjen e KKMPK-së brenda 5 ditëve.

6. Brenda 10 ditëve nga njoftimi, palët fillojnë negocimin e kushteve të marrëveshjes së themelimit të fondacionit.

7. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe partneri strategjik hartojnë aktin e themelimit dhe statutin dhe procedojnë me regjistrimin e fondacionit pranë organeve kompetente në përputhje me legjislacionin për organizatat jofitimprurëse brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit.

8. Pas themelimit të fondacionit të posaçëm, KKMPK-ja nëpërmjet sekretarisë së saj teknike, harton projekt marrëveshjen e administrimit të pasurisë kulturore dhe ia përcjell palëve për t'u dakordësuar brenda afatit të përcaktuar në vendimin e KKMPK-së.

9. Pas dakordësisë së palëve, KKMPK-ja brenda 30 ditëve merr në shqyrtim projekt marrëveshjen dhe vendos:

a) miratimin ose jo të marrëveshjes së dakordësuar për kalimin e pasurisë kulturore në administrim;

b) në rast miratimi, autorizimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore për lidhjen e marrëveshjes së administrimit.

10. Pas miratimit nga KKMPK-ja, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidh marrëveshjen e administrimit me fondacionin e posaçëm.

11. Marrëveshja e nënshkruar me fondacionin e posaçëm miratohet nga Këshilli i Ministrave në rastin e kalimit të administrimit të pasurisë kulturore “me rëndësi kombëtare” dhe “me rëndësi lokale”, e më pas nga Kuvendi në rastin e kalimit të administrimit të pasurisë kulturore “me rëndësi universale”.

B. Procedura për kalimin në administrim indirekt me iniciativë të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore kur vlerëson të kalojë pasuri kulturore në administrim indirekt shpall ftesën për shprehje interesi në buletin e njoftimeve zyrtare dhe në fagen elektronike zyrtare të saj.

2. Subjektet e interesuara duhet të plotësojnë e kriteret e parashikuara në vendimin nr. 625, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit”, dhe në pikën 1, të germës A, të këtij kreu.

3. Njoftimi për botim përmban:

a) kriteret që duhet të plotësojnë subjektet e interesuara;

b) dokumentacionin sipas pikës 1, të germës A, të këtij kreu përveç planit të biznesit;

c) planin e biznesit për zhvillimin e aktivitetit të fondacionit të posaçëm për kryerjen e administrimit dhe aktiviteteve të tjera të parashikuara nga ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

d) datën, vendin dhe orën ku duhet të paraqitet kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues i subjekteve të interesuara.

4. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore mund të lidhë marrëveshjen për bashkëpunim me një ose disa partnerë strategjikë.

5. Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të shprehjes së interesit nga subjektet e interesuara, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore i përcjell dokumentacionin KKMPK-së, e cila vijon me procedurën, sipas pikave 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, të germës A, të këtij kreu.

V. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Çdo akt ose rregullim që bie në kundërshtim me këtë udhëzim shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS

Elva Margariti

**URDHËR****Nr. 566, datë 15.10.2019**

**PËR PËRDITËSIMIN E URDHËRIT TË
MINISTRIT NR. 72, DATË 2.3.2017 “PËR
MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE
NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës si dhe të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, datë 14.10.2016, “Për mbrojtjen e bimëve”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, i ndryshuar, bëhet përditësimi, me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) miratohen për shtim në listën 2, 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

b) rinovohen regjistrimet për 3 (tri) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

c) zgjaten afatet e regjistrimit për 68 (gjashtëdhjetë e tetë) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

ç) hiqen 3 (tri) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi**

1. MIRATOHEN PËR SHTIM NË LISTËN 2, LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe Nr. identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Aplikant	Hyrja në fuqi	Skadimi	Dispozita specifike
1	Florpyrauxifen-benzyl CAS Nr: 1390661-72-9 CIPAC Nr: 990.227	benzyl 4-amino-3-chloro-6-(4-chloro-2-fluoro-3-methoxyphenyl)-5-fluoropyridine-2-carboxylate	≥ 920 g/kg. Papastërtia toluene jo mbi 3 g/kg në materialin teknik.	Dow AgroSciences	24/7/ 2019	24/7/2029	Registrohet për përdorime si Herbicid.
2	Bacillus subtilis strain IAB/BS03 CECT: 7254 DSM: 24682	Nuk aplikohet.	Perqendrimi minimal: 1×10 ¹³ CFU/kg. Perqendrimi maksimal: 5×10 ¹³ CFU/kg.	Investigaciones y Aplicaciones Biotecnológicas S.L.	20/10/ 2019	20/10/2034	Registrohet për përdorime si Fungicid.

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

2. RINOVHEN REGJISTRIMET PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1. Tolclofos-methyl, deri 31 gusht 2034. Registrohet vetëm për përdorim në bimë zbukuruese dhe patate.

2. 1-methylcyclopropene, deri 31 korrik 2034. Registrohet vetëm për përdorim si rregullator i rritjes së bimëve për ruajtjen pas vjeljes në mjedis të mbyllur.

3. Dimethenamid-P, deri 31 gusht 2034.

Gjithsej: 3 (tri) lëndë vepruese.

3. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

Deri më 31 korrik 2022:

1. Aclonifen

2. Imidacloprid

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

Deri më 31 korrik 2021:

1. Metazachlor

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

Deri më 31 gusht 2022:

1. Acetic acid

2. Calcium carbide

3. Denathonium benzoate

4. Ethylene

5. Plant oils/Citronella oil

6. Plant oils/Clove oil

7. Plant oils/Spear mint oil

8. Aluminium phosphide

9. Calcium phosphide

10. Magnesium phosphide



11. Dodemorph
12. 2,5-Dichlorobenzoic acid methylester
13. Metamitron
14. Sulcotrione

Gjithsej: 14 (katërbëdhjetë) lëndë vepruese.

Deri më 31 gusht 2020:

1. Aluminium ammonium sulphate
2. Aluminium silicate
3. Blood meal
4. Calcium carbonate
5. Carbon dioxide
6. Extract from tea tree
7. Fat distillation residues
8. Fatty acids C7 to C20
9. Garlic extract
10. Gibberellic acid
11. Gibberellin
12. Hydrolysed proteins
13. Iron sulphate
14. Kieselgur (diatomaceous earth)
15. Pepper dust extraction residue (PDER)
16. Plant oils/Rape seed oil
17. Potassium hydrogen carbonate
18. Quartz sand
19. Repellents by smell of animal or plant

origin/sheep fat

20. Sodium aluminium silicate
21. Straight Chain Lepidopteran Pheromones
22. Urea

Gjithsej: 22 (njëzetë e dy) lëndë vepruese.

Deri më 31 gusht 2021:

1. Cymoxanil

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

Deri më 31 tetor 2020:

1. Deltamethrin
2. Beta-cyfluthrin
3. Flufenacet
4. Fosthiazate
5. Chlorotoluron
6. Cypermethrin
7. Daminozide
8. Thiophanate-methyl
9. MCPA
10. MCPB
11. Indoxacarb
12. Prosulfocarb
13. Fludioxonil
14. Clomazone

Gjithsej: 14 (katërbëdhjetë) lëndë vepruese.

Deri më 31 dhjetor 2020:

1. Amidosulfuron
2. Nicosulfuron
3. Clofentezine
4. Dicamba
5. Difenoconazole
6. Diflubenzuron
7. Lenacil
8. Picloram
9. Pyriproxyfen
10. Bifenox
11. Diflufenican
12. Fenoxaprop-P
13. Fenpropidin
14. Tritosulfuron
15. Triflurosulfuron

Gjithsej: 15 (pesëmbëdhjetë) lëndë vepruese.

4. HIQEN LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1. Desmedipham

Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë Desmedipham, deri më 1 janar 2020.

2. Dimethoate

Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë Dimethoate, deri më 17 janar 2020.

3. Methiocarb

Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë Methiocarb, deri më 3 janar 2020.

Gjithsej: 3 (tri) lëndë vepruese.

URDHËR

Nr. 278, datë 31.10.2019

**PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
TË KOMPETENCAVE**

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të VKM-së nr. 58 datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, nenit 26 të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015 “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, i ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrimit Qendror, z. Agron Cani.

2. Z. Agron Cani i delegohen kompetencat si më poshtë:

- ndjek dhe zbaton “Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, i ndryshuar;

- ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të DSIK-së;

- ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;

- merr dhe trajton korrespondencën shkresore.

3. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit në funksion të Kontrollit të Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit, përgjegjësit të sektorit për Kontrollin e Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit, z. Adhurim Hasanaj.

4. Z. Adhurim Hasanaj i delegohen kompetencat, si më poshtë:

- a) mbikëqyr dhe udhëzon Grupin e Punës për Kontrollin e Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij;

- b) përfaqëson Grupin e Punës në marrëdhëniet me:

- Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK);

- Kolegjin e Apelit (KA) dhe Komisionerët Publikë;

- Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).

- c) organizon dhe drejton veprimtarinë e Grupit të Punës;

- ç) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave për të cilat është ngritur Grupi i Punës;

- d) merr dhe trajton korrespondencën shkresore që lidhet me veprimtarinë e Grupit të Punës.

5. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 4.11.2019, deri në datën 11.11.2019.

6. Z. Agron Cani dhe z. Adhurim Hasanaj nuk mund të nëndelegojnë këto kompetenca.

7. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrimit Qendror.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR
Dorian Tola

KËRKESË

Nr. 4029/10, datë 31.10.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksion i rrugëve, trotuareve dhe ndriçimit në lagjen ‘30-vjetori’ (zona e ish-pjeshkores)”, Berat.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 13 836 109.10 (trembëdhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e nëntë pikë dhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



Lista paraprake e pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: “Rikonstruksimi i rrugëve, trotuareve dhe ndriçimit në lagjen ‘30-vjetori’ (zona e ish-pjeshkores)”, Berat

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi	Vlera totale / lekë	Shënime konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja
					tokë truall / m ²	tokë truall/m ²		
1	Avenir Misir Mulita dhe Gazmend Misir Mulita	8502	17/63	240.20	19	4,183.00	79,477.00	Kufizohet pasuria për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor të origjinës së pronës
2	Avenir Misir Mulita	8502	17/193	254.30	19	4,183.00	79,477.00	Kufizohet pasuria për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor të origjinës së pronës
3	Gazmir Misir Mulita	8502	17/192	246.20	19	4,183.00	79,477.00	Kufizohet pasuria për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor të origjinës së pronës
4	Maksut Nazif Kroj	8502	17/61	550.10	46	4,183.00	192,418.00	Kufizohet pasuria për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor të origjinës së pronës
5	Arian Agim Idrizi	8502	17/157	300.40	29	4,183.00	121,307.00	Kufizohet pasuria për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor të origjinës së pronës
6	Arben Hysni Ramadani	8502	17/41	950.20	33	4,183.00	138,039.00	
7	Shkelqim Demir Guri	8502	17/152	355.30	16	4,183.00	66,928.00	
8	Ahmet Demir Guri	8502	17/153	375.60	24	4,183.00	100,392.00	
9	Fatmir Faik Skendo	8502	17/189	500.10	37.3	4,183.00	156,025.90	
10	Aleks Shaban Seleni	8502	17/68	1,000.20	48.2	4,183.00	201,620.60	Kufizohen veprimet mbi pasurinë për mungesë dokumentacioni në lidhje me referencën 06326 (e dubluar)
11	Aferdita Sami Ruzi, Agim Mahir Ruzi, Ajet Haki Ruzi, Argjenda Haki Arapi, Artur Shpetim Ruzi, Beniamin Sami Ruzi, Diana Mahir Mucogllava, Emine Mahir Prifti, Ermira Shpetim Ruzi, Etleva Shpetim Kameniku, Fatos Mahir Ruzi, Gazment Sami Ruzi, Gjylzare Haki Meksi, Halil Tefik Ruzi, Henrieta Haki Kallushi, Irma Sami Dibra, Izabela Haki Loshi, Kanerina Sami Topi, Mahmudie Haki Theka, Majlinda Haki Qirollari, Nuri Tefik Ruzi, Sabrije Hajdar Ruzi, Sare Haki Xhindoli, Shpresa Haki Kristo, Tefik Mahir Ruzi, Ylli Sami Ruzi	8502	17/188	1,720.10	724	4,183.00	3,028,492.00	
12	Paqor Asqeri Zinxhiria, Yllka Ramadan Zinxhiria	8502	17/121	400.50	16	4,183.00	66,928.00	Në favor të Banka Credins sh.a.
13	Blenard Kastriot Ziraj	8502	17/62	500.30	13	4,183.00	54,379.00	
	Niko Ali Mançe	8502	17/181	1,250.10	94.5	4,183.00	395,293.50	
15	Kozma Naun Kurici	8502	17/155	600.30	109	4,183.00	455,947.00	Kufizohet pasuria për mungesë dokumentacioni te plotë ligjor
16	Dhimo Spiro Kurici	8502	17/156	400.00	33.6	4,183.00	140,548.80	
17	Dylber Feizi Metohu	8502	17/159	300.00	15.1	4,183.00	63,163.30	Kufizohet pasuria për mungesë



								dokumentacioni te plotë ligjor
18	Nikolla Thoma Karadumi , Tabene Teme Mucogllava, Vangjel Thoma Karadumi	8502	17/15	664.30	45	4,183.00	188,235.00	Me urdhër nr. 19, dt. 26.6.2013, kufizohet
19	Behar Nazif Zere	8502	17/14	1,146.30	200	4,183.00	836,600.00	Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm
20	Ilir Iliaz Taka	8502	17/163	100.20	30	4,183.00	125,490.00	Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm
21	Asqeri Rapo Cela	8502	17/86	394.00	31	4,183.00	129,673.00	Kufizohet për mungesë të dokumentacionit original për origjinën e pronës
22	Dhimiter Ndini Guli	8502	18/120	500.50	40	4,183.00	167,320.00	
23	Artan Qatip Agalliu	8502	18/121	499.70	49	4,183.00	204,967.00	
24	Ilirjan Mustafa Ramaj	8502	18/99	714.00	31	4,183.00	129,673.00	Kufizohet për mungesë të dokumentacionit original për origjinën e pronës
25	Ilir Sali Mance	8502	18/106	724.00	20	4,183.00	83,660.00	Kufizohet për mungesë të dokumentacionit original për origjinën e pronës
26	Kisha e Lire Ungjillore	8502	18/103	127.40	26	4,183.00	108,758.00	Kufizohet për mungesë të dokumentacionit original për origjinën e pronës
27	Veledin Bajram Hysi	8502	18/32	620.00	56	4,183.00	234,248.00	Në favor të Alpha Bank
28	Bojken Skender Kola	8502	18/165	14.30	2	4,183.00	8,366.00	
29	Ardian Xhemil Allajbej	8502	17/59	408.10	10	4,183.00	41,830.00	
30	Kisha e Lire Ungjillore	8502	18/104	367.00	11	4,183.00	46,013.00	Kufizohet për mungesë të dokumentacionit original për origjinën e pronës
31	Hysni Rushan Kurti , Leonard Hysni Kurti	8502	17/119	516.50	13	4,183.00	54,379.00	
32	Spiro Jani Cuka	8502	17/51	1,389.90	4	4,183.00	16,732.00	Kufizohet pasuria për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor të origjinës së pronës
33	Ferdinant Luan Arapi	8502	18/107	725.20	37	4,183.00	154,771.00	
34	Ilia Dini Veliaj	8502	17/80	205.00	8	4,183.00	33,464.00	Me urdhër nr. 19, dt. 26.6.2013, kufizohet
35	Gramoz Abedin Veliaj	8502	17/81	221.00	22	4,183.00	92,026.00	Me urdhër nr.19, dt. 26.6.2013, kufizohet. Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm
36	Faik Dino Veliaj	8502	17/82	220.10	14	4,183.00	58,562.00	Me urdhër nr.19, dt. 26.6.2013, kufizohet
37	Qazim Ilias Malasi	8502	18/70	350.10	4	4,183.00	16,732.00	Me urdhër nr.19, dt. 26.6.2013, kufizohet
38	Shefiko Qani Veliaj	8502	17/10	655.30	142	4,183.00	593,986.00	Me urdhër nr.19, dt. 26.06.2013, kufizohet
39	Andrea Kostandin Bendi, Anxhela Lambi Bendi, Katerina Kostandin Melengu, Liljana Vangjel Bendi , Olimbi Toli Bendi,Rajmonda Kostandin Shtrepi, Sokrat Kostandin Bendi, Sotirag Kostandin Bendi,Sokrat Vangjel Bendi, Vangjeljan Llambi Bendi, Vasil Kostandin Bendi	8502	17/100	1,250.00	350	4,183.00	1,464,050.00	Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm
40	Koco Ligor Dhimitri	8502	18/39	500.20	51	4,183.00	213,333.00	
41	Fitim Sali Myzyri	8502	17/325	604.20	158	4,183.00	660,914.00	Kufizohet pasuria për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor të origjinës së pronës



42	Ali Dane Mucolli, Dallandyshe Myrteza Asllanaj, Gramoz Myrteza Mucolli, Lumir Myrteza Mucolli, Nuriye Mucolli	8502	17/326	504.30	50	4,183.00	209,150.00	Kufizohet pasuria për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor të originës së pronës
43	Ahmet Muharrem Mino , Hatixhe Muharrem Mino, Nadire Muharrem Mino, Petrit Muharrem Mino , Sadete Muharrem Mino, Sheval Muharrem Mino, Subije Muharrem Mino, Xhezmije Muharrem Mino	8502	17/327	602.30	602	4,183.00	2,518,166.00	Kufizohet pasuria për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor të originës së pronës
44	Ekuran Feizi Metohu	8502	17/198	416.60	6	4,183.00	25,098.00	
Totali							13,836,109.10	

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 03(64-2019-1912), datë 19.9.2019, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasës Majlinda Mehmet Adile Nurçe, e datëlindjes 6.5.1969, si dhe caktimin e saj nën kujdestarinë ligjore të kërkuesit Ledi Mehmet Adile Nurçe.

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 04(64-2019-1949), datë 26.9.2019, vendosi heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Ardian Peqini, e datëlindjes 3.10.1984, si dhe caktimin e tij nën kujdestarinë ligjore të shtetasës Fatbardha Peqini.

KËRKESE

Shtetasja Rudine Toni, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shpalljen të zhdukur të shtetasit Gjon Toni, i datëlindjes 24.6.1942, lindur dhe banues në Rrenc, Njësia Administrative Gur i Zi.

KËRKUESE
Rudine Toni

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 476 lekë